



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

4038
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 09/10.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 64

Datë: 01.10.2025 si dhe projekt-vendimin nr.03 Datë 19.09.2025.

“Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për Mundësi e pagesës së tarifës së shërbimit të parkimit publik në qytetin e Peshkopisë, nëpërmjet SMS-ve të mundësuar nëpërmjet telefonisë së lëvizshme”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



10.10.2025
ms



4038/17/10/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.915/1 prot.

Peshkopi, më 17.10.2025

Lënda: Për vendimin nr.64, datë 01.10.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.


BASHKISË DIBËR

KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.64, datë 01.10.2025 **“Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për mundësinë e pagesës së tarifës së shërbimit të parkimit publik në qytetin e Peshkopisë, nëpërmjet sms-ve të mundësuar nëpërmjet telefonisë së lëvizshme”**, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM

Nr. 64 Datë 01/10/2025

“Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për Mundësinë e pagesës së tarifës së shërbimit të parkimit publik në qytetin e Peshkopisë, nëpërmjet SMS-ve të mundësuarra nëpërmjet telefonisë së lëvizshme”.

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar,Ligji nr.44/2015 Kodi I Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.7850 datë 29.07.1994, “Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë”,I ndryshuar, Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet ONE Albania,Sh.A,Vodafone Albania Sh.A dhe Bashkisë Dibër, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **01.10.2025** me 21 vota pro 1 kundër 0 apstenim :

VENDOSI:

1. Te miratojë me ndryshime marrëveshjen e bashkëpunimit për “Mundësinë e pagesës së tarifës së shërbimit të parkimit publik në qytetin e Peshkopisë,nëpërmjet SMS-ve të mundësuarra nëpërmjet telefonisë së lëvizshme”.
 - Të ofrohet shërbim i drejtpërdrejt(me pagesë cash nëpërmjet biletave)
 - Ulja e koston(%) për vlerën totale që kërkojnë operatorët
2. Shërbimi i pagesës me SMS do të quhet pagesa e tarifës së shërbimit publik të parkimit në qytetin e Peshkopisë e administruar nëpërmjet software,në sajë të të cilit Pajtimtarët e ONE dhe Vodafonë kryejnë pagesën përkatëse përmes dërgimit të një SMS ne numrin e shkurtër (short code) të pëcaktuar nga Bashkia.”
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit Drejtoria e Taksave,Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall më datë **01.10.2025**.

Zv/Kryetari i Këshillit Bashkiak

Mario FEJZA



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA JURIDIKE, E PROKURIMEVE DHE PRONAVE
P/ VENDIM

Nr. 03 date 19/09 / 2025

“Për miratimin e marrëveshjes së bashkpunimit për “Mundësinë e pagesës së tarifës së shërbimit të parkimit publik në qytetin e Dibrës, nëpërmjet SMS-ve të mundësuar nëpërmjet telefonisë së lëvizshme”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Ligji nr.44/2015 Kodi I Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.7850, date 29.07.1994 “Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar Marveshja e Bashkupnimit ndërmjet ONE Albania, Sh.A ; Vodafone Albania Sh.A dhe dhe Bashkisë Dibër.

KËRKOJMË:

1. Të miratojë marrëveshjen e bashkpunimit për “Për miratimin e marrëveshjes së bashkpunimit për “Mundësinë e pagesës së tarifës së shërbimit të parkimit publik në qytetin e Dibrës, nëpërmjet SMS-ve të mundësuar nëpërmjet telefonisë së lëvizshme”.
2. Shërbimi i pagesës me SMS do të quhet pagesa e tarifës së shërbimit public të parkimit në qytetin e Dibrës e administruar nëpërmjet softwarë, në sajë të të cilit Pajtimtarët e One dhe Vodafone kryejnë pagesën përkatëse përmes dërgimit të një SMS në numrin e shkurtër (short code) të përcaktuar nga Bashkia.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Drejtoria e Taksave dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmeri ligjore nga institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.

Drejtori Taksave

Fitim RASKA



Drejtori Juridik

Ismet SARACI



Drejtori Ekonomik

Çeljeta ZUNA



KRYETARI I BASHKISE

Rahim SPAHIU

ME URDHER DHE ME POROSI

ZV/KRYETARI

Lorenc CIBAKU



SHTOJCE 2 PËR PËRPUNIMIN E PËRBASHKËT TË TË DHËNAVE PERSONALE

(Bashkëkontrollues për Shërbimin e Parkimit me Pagesë përmes SMS-ve)

Kjo kontratë ("Kontrata") është lidhur më datë [] ndërmjet:

1. **One Albania sha** një subjekt juridik i regjistruar sipas ligjeve të Shtetit Shqiptar, me numër regjistrimi J61814094W me adresë në Rr. Muhedin Llagami, Kompleksi Square 21, Kati 2, Tirane, përfaqësuar nga z. Brano Djurovic, Drejtor Ekzekutiv, në cilësinë e Bashkëkontrolluesit 1

2. **Bashkia Diber**, një autoritet publik, me adresë në Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Diber, përfaqësuar nga Kryetari, Z. Rahim Spahiu, në cilësinë e Bashkëkontrolluesit 2.

(Kolektivisht referuar si "Palët" dhe individualisht si "Pala").

1. OBJEKTI I KONTRATËS

1.1. Palët bien dakord të përpunojnë të dhënat personale në mënyrë të përbashkët për të ofruar një shërbim parkimi me pagesë përmes SMS-ve, në përputhje me Ligjin Nr.124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri si dhe ligjet e tjera të aplikueshme.

1.2. Përpunimi i të dhënave personale do të përfshijë:

- Numrin e telefonit të përdoruesit;
- Orarin dhe datën e parkimit;
- Zonën e parkimit;
- Pagesat e kryera dhe historikun e transaksioneve.

2. PËRGJEGJËSITË E PALËVE

2.1. Bashkëkontrolluesit bien dakord të ndajnë përgjegjësinë për:

- Marrjen e pëlqimit ose sigurimin e një baze ligjore për përpunimin e të dhënave personale;
- Përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave sipas ligjeve në fuqi;
- Lehtësimin e ushtrimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave;
- Masat teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave.

2.2. Ndarja e Përgjegjësisë

- Bashkëkontrolluesi 1 do të jetë përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e platformës teknologjike për dërgimin e SMS-ve.

- Bashkëkontrolluesi 2 do të jetë përgjegjës për arkëtimin e pagesave dhe menaxhimin financiar të shërbimit.

- Të dyja Palët do të bashkëpunojnë për trajtimin e kërkesave të subjekteve të të dhënave në lidhje me aksesin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të tyre.

3. QËLLIMI DHE BAZA LIGJORE E PËRPUNIMIT

3.1. Përpunimi i të dhënave bëhet me qëllim:

- Ofrimin e shërbimit të parkimit me pagesë përmes SMS-ve;
- Administrimin e transaksioneve dhe faturimin;
- Monitorimin dhe raportimin e parkimeve sipas rregullave të vendosura nga autoritetet.

3.2. Baza ligjore për përpunimin është:

- Zbatimi i një kontrate (neni 7 b Ligjit Nr.124/2024 "Per Mbrojtjen e te dhenave Personale") për kryerjen e pagesës dhe ofrimin e shërbimit;
- Interesi legjitim (neni 7 c i Ligjit Nr. 124/2024 "Per mbrojtjen e te dhenave Personale") për të garantuar funksionimin e shërbimit dhe mbrojtjen nga mashtrimet.

4. USHTRIMI I TË DREJTAVE NGA SUBJEKTET E TË DHËNAVE

4.1. Palët angazhohen të respektojnë të drejtat e subjekteve të të dhënave, përfshirë:

- Të drejtën për informacion mbi përpunimin e të dhënave;
- Të drejtën për akses, korrigjim dhe fshirje të të dhënave;
- Të drejtën për kundërshtim ndaj përpunimit ose për kufizim të përpunimit;
- Të drejtën për të mos iu nënshtuar vendimmarrjes së automatizuar, përfshirë profilizimin.

4.2. Kërkesat e subjekteve të të dhënave do të trajtohen nga Pala që merr kërkesën, me njoftim të menjëhershëm për Palën tjetër, nëse është e nevojshme.

5. MASAT TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE

5.1. Palët do të zbatojnë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale, duke përfshirë:

- Enkriptimin ose anonimizimin e të dhënave, kur është e mundur;
- Kufizimin e aksesit të personelit në të dhënat personale;
- Monitorimin dhe auditimin periodik të sistemeve për të garantuar sigurinë e të dhënave.

6. TRANSFERIMI NDËRKOMBËTAR I TË DHËNAVE

6.1. Nëse të dhënat personale transferohen jashtë Zonës Ekonomike Evropiane (EEA) ose vendeve të Bashkimit Europian, Palët do të zbatojnë mekanizmat e duhur ligjorë, si Klauzolat Standard të Kontratës (SCCs) ose një vendim të përshtatshëm nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave Personale në Shqipëri.

7. KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

7.1. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë **3 (tre) vjeçare** dhe mund të rinovohet me marrëveshje të ndërsjellë.

7.2. Në rast të përfundimit të kontratës, Palët do të sigurojnë që të dhënat personale të fshihen ose të anonimizohen, përveç rasteve kur ruajtja e tyre kërkohet me ligj.

8. DISPOZITA TË FUNDIT

8.1. Çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet fillimisht nëpërmjet negociatave ndërmjet Palëve. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, çështja do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane.

8.2. Kjo kontratë mund të ndryshohet vetëm me shkrim dhe me miratimin e të dyja Palëve.

PËRFAQËSUESIT E PALËVE

Për: One Albania sha (Bashkekontrolluesi Nr.1)

Emri: Brano Djurovic

Pozicioni: Drejtor Ekzekutiv

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Për: Bashkia Dibër (Bashkekontrolluesi Nr.2)

Emri: Rahim Spahiu

Pozicioni: Kryetar

Nënshkrimi: _____

Data: _____

SHTOJCE 2 PËR PËRPUNIMIN E PËRBASHKËT TË TË DHËNAVE PERSONALE

(Bashkëkontrollues për Shërbimin e Parkimit me Pagesë përmes SMS-ve)

Kjo kontratë ("Kontrata") është lidhur më datë [] ndërmjet:

1. **One Albania sha** një subjekt juridik i regjistruar sipas ligjeve të Shtetit Shqiptar, me numër regjistrimi J61814094W me adresë në Rr. Muhedin Llagami, Kompleksi Square 21, Kati 2, Tiranë, përfaqësuar nga z. Brano Djurovic, Drejtor Ekzekutiv, në cilësinë e Bashkëkontrolluesit 1

2. **Bashkia Diber**, një autoritet publik, me adresë në Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Diber, përfaqësuar nga Kryetari, Z. Rahim Spahiu, në cilësinë e Bashkëkontrolluesit 2.

(Kolektivisht referuar si "Palët" dhe individualisht si "Pala").

1. OBJEKTI I KONTRATËS

1.1. Palët bien dakord të përpunojnë të dhënat personale në mënyrë të përbashkët për të ofruar një shërbim parkimi me pagesë përmes SMS-ve, në përputhje me Ligjin Nr.124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri si dhe ligjet e tjera të aplikueshme.

1.2. Përpunimi i të dhënave personale do të përfshijë:

- Numrin e telefonit të përdoruesit;
- Orarin dhe datën e parkimit;
- Zonën e parkimit;
- Pagesat e kryera dhe historikun e transaksioneve.

2. PËRGJEGJËSITË E PALËVE

2.1. Bashkëkontrolluesit bien dakord të ndajnë përgjegjësinë për:

- Marrjen e pëlqimit ose sigurimin e një hape ligjore për përpunimin e të dhënave personale;
- Përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave sipas ligjeve në fuqi;
- Lehtësimin e ushtrimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave;
- Masat teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave.

2.2. Ndarja e Përgjegjësisë

- Bashkëkontrolluesi 1 do të jetë përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e platformës teknologjike për dërgimin e SMS-ve.

- Bashkëkontrolluesi 2 do të jetë përgjegjës për arkëtimin e pagesave dhe menaxhimin financiar të shërbimit.

- Të dyja Palët do të bashkëpunojnë për trajtimin e kërkesave të subjekteve të të dhënave në lidhje me aksesin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të tyre.

3. QËLLIMI DHE BAZA LIGJORE E PËRPUNIMIT

3.1. Përpunimi i të dhënave bëhet me qëllim:

- Ofrimin e shërbimit të parkimit me pagesë përmes SMS-ve;
- Administrimin e transaksioneve dhe faturimin;
- Monitorimin dhe raportimin e parkimeve sipas rregullave të vendosura nga autoritetet.

3.2. Baza ligjore për përpunimin është:

- Zbatimi i një kontrate (neni 7 b Ligjit Nr.124/2024 "Per Mbrojtjen e te dhenave Personale") për kryerjen e pagesës dhe ofrimin e shërbimit;
- Interesi legjitim (neni 7 c i Ligjit Nr. 124/2024 "Per mbrojtjen e te dhenave Personale") për të garantuar funksionimin e shërbimit dhe mbrojtjen nga mashtrimet.

4. USHTRIMI I TË DREJTAVE NGA SUBJEKTET E TË DHËNAVE

4.1. Palët angazhohen të respektojnë të drejtat e subjekteve të të dhënave, përfshirë:

- Të drejtën për informacion mbi përpunimin e të dhënave;
- Të drejtën për akses, korrigjim dhe fshirje të të dhënave;
- Të drejtën për kundërshtim ndaj përpunimit ose për kufizim të përpunimit;
- Të drejtën për të mos iu nënshtruar vendimarrjes së automatizuar, përfshirë profilizimin.

4.2. Kërkesat e subjekteve të të dhënave do të trajtohen nga Pala që merr kërkesën, me njoftim të menjëhershëm për Palën tjetër, nëse është e nevojshme.

5. MASAT TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE

5.1. Palët do të zbatojnë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale, duke përfshirë:

- Enkriptimin ose anonimizimin e të dhënave, kur është e mundur;
- Kufizimin e aksesit të personelit në të dhënat personale;
- Monitorimin dhe auditimin periodik të sistemeve për të garantuar sigurinë e të dhënave.

6. TRANSFERIMI NDËRKOMBËTAR I TË DHËNAVE

6.1. Nëse të dhënat personale transferohen jashtë Zonës Ekonomike Evropiane (EEA) ose vendeve të Bashkimit Europian, Palët do të zbatojnë mekanizmat e duhur ligjorë, si Klauzolat Standard të Kontratës (SCCs) ose një vendim të përshtatshëm nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri.

7. KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

7.1. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë **3 (tre) vjeçare** dhe mund të rinovohet me marrëveshje të ndërsjellë.

7.2. Në rast të përfundimit të kontratës, Palët do të sigurojnë që të dhënat personale të fshihen ose të anonimizohen, përveç rasteve kur ruajtja e tyre kërkohet me ligj.

8. DISPOZITA TË FUNDIT

8.1. Çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet fillimisht nëpërmjet negociatave ndërmjet Palëve. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, çështja do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

8.2. Kjo kontratë mund të ndryshohet vetëm me shkrim dhe me miratimin e të dyja Palëve.

PËRFAQËSUESIT E PALËVE

Për: One Albania sha (Bashkekontrolluesi Nr.1)

Emri: Brano Djurovic

Pozicioni: Drejtor Ekzekutiv

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Për: Bashkia Dibër (Bashkekontrolluesi Nr.2)

Emri: Rahim Spahiu

Pozicioni: Kryetar

Nënshkrimi: _____

Data: _____